



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 48/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 20.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

Me datën 19.04.2012, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, parashtruar ndaj subjektit politik AAK përkatësisht ndaj kandidatit të saj për kryetar të Komunës së Ferizajt, me të cilën pretendohet se ka filluar fushatën e tij zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, duke publikuar fotot dhe numrin e kandidatit për kryetar të komunës, sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullës Zgjedhore, *Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatë*, pasi që periudha zyrtare e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, është nga data 23 deri 27 Prill 2012.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotot e publikuara në hapësira publike si dhe fotot e printuara nga faqja zyrtare e kandidatit për kryetar të Komunës në Ferizaj, në rrjetin social në Facebook.

Neni 33 dhe 44 i LZP-së, Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Siç del nga shkresat e lëndës pretendimet në ankesë nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe duke u bazuar në dispozitat lartcekura ligjore PZAP-i, konstatoi se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara të subjekteve politike, ngase në LZP-, e as ne Rregulla Zgjedhore nuk është paraparë asnjë dispozitë ligjore që e ndalojnë fillimin e fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 48/2012 më datën 20.04.2012.

**Kryesuesi i panelit
Muhamet Rexha**

